



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 5

Prishtinë, më 13.12.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë : Daut Haradinaj, Besa Gaxherri, Ganimete Musliu, Lutfi Zharku, Danush Ademi, Andin Hoti, Sërgjan Mitrovic dhe Salih Salihu.

Munguan : Enver Hoti dhe Driton Çausi.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Daut Haradinaj**, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 6.11.2017;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje;
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 6.11.2017 ;

Kryetari i Komisionit, konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje;

Daut Haradinaj, kryetar, përgëzoi zyrtarët e pranishëm nga MMPH-ja rreth dërgimit në Kuvend të këtij projektligji, i cili në këtë komision duhet të shtjellohet duke shpresuar që tani kemi një draft më të mirë, ashtu siç është pritur nga të interesuarit në përgjithësi, ngase në përditshmëri janë krijuar mjaft situata jo të mira për shkak të mungesës së këtij Ligji. Ai propozoi miratimin në parim dhe sugjeroi që **Liburn Aliu** në mbledhjen plenare të arsyetojë rekomandimin e Komisionit për miratim në parim, dhe hapi diskutimin.

Liburn Aliu, gjithashtu ishte i mendimit se duhet të kalojë ky projektligj ngase është më i avancuar sesa ai në fuqi, pasi që është punuar mjaft shumë, MMPH-ja ka bashkëpunuar me të gjithë, ka pasur diskutime publike dhe komunat kanë qenë të përfshira. Po ashtu, Aliu potencoi se vërejtjet që janë paraqitë gjatë hartimit, janë në fund të projektligjit të bashkangjitura si komente, të cilat do të shërbejnë gjatë shqyrtimit në komision. Për të mos dështuar ky projekt, ai propozoi një punë shumë serioze por edhe të kushtueshme, ngase përveç që duhet të sqarohen disa çështje si p.sh. data e hyrjes në fuqi të Ligjit-legalizimit, duhet që secila komunë të ketë ortofoto si garanci që nuk do të krijohen situata konfliktuale (kjo do të kushtojë financiarisht), ngase me rastin e hyrjes në fuqi të ligjit aktual, nuk janë gjetur disa ndërtime. Do të thotë, duhet të krijohen kushtet që secila komunë dhe në përgjithësi secili i interesuar para veti të ketë ortofoto. Edhe një problem tjetër shumë me rëndësi : sigurimi i stafit, ngase legalizimet do të krijojnë nevojën e rritjes së stafit për shkak të planifikimeve të legalizimeve. Këto dy probleme (ortofotot dhe sigurimi i stafit) dhe të gjitha tjerat duhet të zgjidhen bashkërisht midis trekëndëshit Komisioni Parlamentar, MMPH-ja dhe komunat, nëse dëshirojmë jo vetëm një ligj por edhe zgjidhjen e mirëfilltë të problemit të këtyre ndërtimeve.

Daut Haradinaj, në vazhdim i ceku edhe disa çështje tjera nga Raporti preliminar i përgatitur nga Drejtoria për Standardizim, Përafrim dhe Harmonizim Ligjor, siç janë sqarimi se çka nënkuptohet “leje tjetër” në Nenin 3 dhe të përkufizohet „certifikata e përdorimit“ në nenin 19, si dhe u pajtua me z. Aliu që pas leximit të parë dhe krijimit të GP-së do të shqyrtohen edhe ato vërejtje.

Ganimete Musliu, përshëndeti procedimin e këtij projektligji të rëndësishëm dhe pasi që i plotëson kushtet parimore, ajo mbështeti leximin në parim dhe vazhdimin e punës në komision për leximin e dytë. Komisioni njëzëri nxori për mbledhjen plenare këtë :

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji Nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

4.Të ndryshme.

Në pikën të ndryshme, kryetari njoftoi për shkresën e dërguar nga Drejtori i ARRU-së rreth kërkesës për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit në fuqi për rregullimin e shërbimeve të ujit, dhe ftoi stafin që të shpërndajë atë për mbledhjen e radhës, për çka Komisioni do të njoftohet në ditët në vijim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Daut Haradinaj